

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

## Raport sondazhi

# Aktivitete dhe evente artistiko kulturore dhe sportive 2024



Gusht 2024

## **Përmbajtja**

---

Rreth sondazhit	3
Demografia	4
Pjesëmarrja në aktivitete dhe informimi	5
Promovimi dhe pritshmëritë për aktivitetet	8
Interesi për aktivitetet dhe përfshirja e qytetarëve	12
Aneks I – Pyetësi i sondazhit	14
Aneks II – Pikat ku është zhvilluar anketimi	18

## **Rreth sondazhit**

Bashkia e Tiranës planifikon dhe menaxhon çështje që lidhen me hartimin e politikave dhe strategjive që synojnë intensifikimin e jetës artistike, kulturore, përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës sportive, me qëllim shndërrimin e Tiranës në një qytet me standarde europiane. Gjithashtu monitoron organizimin e aktiviteteve promovuese për kulturën, artin, monumentet kulturore, traditën folklorike, artizanatin etj., në bashkëpunim dhe ndërveprim me institucione dhe organizma të specializuara.

Një pjesë e këtyre eventeve kulturore-artistike e sportive janë kthyer në traditë si p.sh.: Javët ndërkombëtare të kulturës, koncerte dhe shfaqje tek Amfiteatri, Panairi i Librit, Festivali Ndërkombëtar i Filmit, Maratona e Tiranës, Tirana Triathlon etj. Bashkia Tiranë organizon dhe mbështet gjithashtu shumë aktivitete të tjera të një shkalle më të vogël si koncerte, recitale, shfaqje filmi, teatrale dhe dokumentarësh, ekspozita artistike, aktivitete sociale dhe kulinarie.

Ndër eventet që kanë tërhequr pjesëmarrje të lartë mund të përmendim:

- Dy fan zone, njëra në Sheshin “Skënderbej” dhe tjetra te Stadiumi “Selman Stërmasi”, si dy hapësira sportive dedikuar tifozëve, dhe të konceptuara në formën e një mini stadiumi;
- Spectapolis Tirana, një arenë rekreative e ngjashme me parqet e argëtimit por e dizenuar për të mirëpritur evente të ndryshme;
- Maratona e Tiranës, si event i madh sporti në Tiranë, e cila mirëpret prej disa vitesh pjesëmarrës jo vetëm nga Shqipëria por nga e gjithë bota etj.

Nëpërmjet këtyre organizimeve synohet rritja e interesit të qytetarëve për të ndjekur dhe për t’u përfshirë në evente dhe aktivitete, duke nisur me fëmijët të cilët duan të festojnë dhe argëtohen, të rinjtë të cilët kanë nevojë të edukohen dhe socializohen, por edhe të rriturit dhe më të moshuarit mund të ndjekin apo të përfshihen në evente dhe aktivitete të përshtatshme për secilën grup-moshë.

**Qëllimi i sondazhit:** Ky sondazh ka për qëllim të evidentojë opinionet për aktivitetet që organizon Bashkia e Tiranës, pjesëmarrjen, pritshmëritë dhe interesin e qytetarëve për t’u bërë pjesë e këtyre organizimeve.

### **Objektivat:**

- a) Pjesëmarrja dhe kanalet e preferuara të informimit;
- b) Aktivitetet dhe eventet më të preferuara;
- c) Vlerësimi për promovimin nga ana e Bashkisë dhe përfitimet për qytetin;
- d) Vlerësimi për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve;
- e) Interesi i qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitete;
- f) Sugjerime për përfshirjen e komunitetit.

Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës **korrik – gusht 2024** dhe u plotësuan **700** pyetësorë<sup>1</sup> rastësorë nëpërmjet anketimit **ballë për ballë** pranë zonave të ndryshme në Tiranë<sup>2</sup>.


---

<sup>1</sup> Aneks I – Pyetësori i sondazhit



<sup>2</sup> Aneks II – Tabela me pikat e anketimit

## Demografia

Të shpërndarë sipas njësive të banimit, **19%** e të anketuarve janë banorë të Njesisë Administrative Nr. 2, 13% janë banorë të Njesisë Administrative Nr. 5, 10% janë banorë të Njesisë Administrative Nr. 10, 9% janë banorë të Njesisë Administrative Nr. 1 etj. (Grafiku 1).



56% e të anketuarve janë femra ndërsa 44% janë meshkuj. Grup - mosha me pjesëmarrjen më të lartë në anketim janë 18 – 35 vjeç dhe 36 – 50 vjeç (përkatësisht 25%) etj. (Grafikët 2 dhe 3).




## Pjesëmarrja në aktivitete dhe informimi

Rreth **30%** e të anketuarve janë përgjigjur se *marrin pjesë shpesh* në aktivitetet artistiko – kulturore dhe eventet sportive që organizon Bashkia e Tiranës, **27%** ndonjëherë, **23%** rrallë dhe **20%** shumë shpesh (*Grafiku 4*).




Rreth **55%** e të anketuarve janë shprehur se *preferojnë të informohen për organizimet* përmes rrjeteve sociale, 45% nga miqtë dhe familja, 30% nga faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë, 23% nga media e shkruar, 22% nga televizioni dhe radio ndërsa 13% nga posterat dhe afisheet (*Grafiku 5*).




Rreth **52%** e të anketuarve kanë përzgjedhur Fan Zone si *aktivitetin kryesor në preferencat e tyre*, 48% kanë përzgjedhur Spectapolis, 33% preferojnë koncertet dhe festivalet që organizohen tek Reja dhe Amfiteatri i Liqenit Artificial, 28% preferojnë te marrin pjesë te Panairi i Librit, 26% në aktivitetin edukues Dita pa Makina, 25% në eventin sportiv Tirana Marathon, 24% në shfaqje operistike tek TKOB etj. (Grafiku 6).

**Grafiku 6. Preferencat për aktivitetet**




## Promovimi dhe pritshmëritë për aktivitetet

Rreth **48%** e të anketuarve mendojnë se Bashkia po bën një *promovim të mirë për aktivitetet dhe eventet*, 36% janë shprehur se promovimi është pjesërisht i mirë, 14% nuk kanë dhënë një mendim ndërsa 2% mendojnë se nuk po bëhet një promovim i mirë (*Grafiku 7*).







Rreth **56%** e të anketuarve mendojnë se *zhvillimi i aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme* nxisin ekonominë lokale, 54% mendojnë se përmirësojnë imazhin dhe reputacionin e qytetit, 53% mendojnë se promovojnë kulturën dhe trashëgiminë lokale, 36% mendojnë se përmirësojnë cilësinë e jetesës për banorët, 29% mendojnë se rrisin angazhimin e komunitetit dhe ndërveprimin social (Grafiku 8).



Rreth **44%** e të anketuarve e vlerësojnë mesatare cilësinë e organizimit dhe mbarëvajtjes së aktiviteteve dhe eventeve, 37% e vlerësojnë të lartë, 11% shumë të lartë, 6% të ulët dhe 2% shumë të ulët (Grafiku 9).




Rreth **42%** e të anketuarve janë shprehur se *pritshmëritë për aktivitetet janë njësoj si vitin e kaluar*, 36% janë shprehur se pritshmëritë janë rritur, 11% janë shprehur se janë rritur shumë, 7% janë shprehur se nuk janë rritur dhe 4% janë shprehur se pritshmëritë nuk janë rritur aspak (*Grafiku 10*).




## Interesi për aktivitetet dhe përfshirja e qytetarëve

Rreth **49%** e të anketuarve mendojnë se *interesi i qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitete është rritur*, 32% janë shprehur se ndoshta është rritur, 12% nuk kanë dhënë një përgjigje ndërsa 7% janë shprehur se nuk është rritur (*Grafiku 11*).



Për sa i përket faktorëve që ndikojnë në pjesëmarrjen në aktivitete dhe evente, të anketuarit si më të rëndësishme kanë vlerësuar mundësinë për të mësuar diçka të re dhe çmimin e biletave (**3.8 pikë përkatësisht**). Mundësinë për të mësuar diçka të re si edhe kohën dhe datën e zhvillimit të aktivitetit i vlerësojnë gjithashtu të rëndësishme për pjesëmarrjen (3.7 pikë përkatësisht). Vendndodhjen e aktivitetit e vlerësojnë me 3.6 pikë, artistin apo performuesin e ftuar me 3.4 pikë dhe tematikën e aktivitetit me 3.2 pikë (Grafiku 12).



Rreth **53%** e të anketuarve kanë sugjeruar se *komuniteti mund të përfshihet më tepër në aktivitete* duke ofruar kushte më të përshtatshme gjatë temperaturave të larta duke vendosur ftohëse, tenda etj. 45% janë shprehur për produkte me çmime të reduktuara për nxënës dhe studentë, 41% për përmirësim të aksesit dhe opsioneve të transportit në vendet ku ka organizime, 30% për internet falas, 28% për bashkëpunime me grupe dhe organizata të komunitetit lokal etj. (Grafiku 13).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT  
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. pyetësoni \_\_\_\_\_

Data e intervistës: \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/2024

**PYETËSOR**

**“Aktivitete dhe evente artistiko kulturore dhe sportive 2024”**

Nj. Administrative/Lagje	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)				
	F	M	Nën 18	18-35	36-50	51-65	Mbi 65

**Seksioni I: Pjesëmarrja dhe informimi**

1. Sa shpesh merrni pjesë në aktivitetet artistiko – kulturore dhe eventet sportive që organizon Bashkia e Tiranës (BT) përgjatë vitit?

Shumë shpesh  Shpesh  Ndonjëherë  Rrallë

2. Si do të preferonit të informoheshit për këto organizime? (Mund të zgjidhni më shumë se 1)

Media (TV, Radio)  Faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë  
 Media e shkruar  Miqtë dhe familja  
 Rrjete sociale Tjetër \_\_\_\_\_  
 Postera dhe afishe

3. Cila/t nga aktivitetet dhe eventet që organizon Bashkia Tiranë gjatë vitit do të ishte në preferencat tuaja? (Mund të zgjidhni më shumë se 1)

Nr. rend	Aktivitete/Evente	Përzgjidh
1	Koncerte dhe festivale (Tek Reja, Amfiteatri, Liqeni Artificial, i Farkës etj.)	
2	Fan Zone (Në sh. Skënderbej, event sportiv, argëtim, kulinari etj.)	
3	Spectapolis (Koncerte, festivale, lojëra etj.)	
4	Kinema verore (Tek Reja, Amfiteatri, Pazari i Ri etj.)	
5	Tirana Marathon (Event sportiv tek Liqeni i Farkës dhe në qytet)	
6	Tirana Triathlon (Event sportiv tek Liqeni i Farkës dhe në qytet)	
7	Shkolla e biçikletave (Rregulla të sigurisë rrugore, të qarkullimit etj.)	

8	<b>Galeria e Artit Tiranë</b> ( <i>Ekspozita, fotografi, pikturë, skulptura, artizanale etj.</i> )	
9	<b>Dita pa Makina</b> ( <i>Aktivitet mjedisor, nxitje për përdorimin e biçikletës</i> )	
10	<b>1 Qershori</b> ( <i>Festë për fëmijë, argëtim, muzikë, lojëra etj.</i> )	
11	<b>Kamp veror për fëmijë</b> ( <i>Edukim, argëtim, lojëra etj. tek Parku i madh i Liqenit</i> )	
12	<b>Festa e fërgesës</b> ( <i>Kulinari tek Kalaja e Tiranës</i> )	
13	<b>Tirana Art Fest</b> ( <i>Festival i shkollave të mesme, këngë, kërcim, instrumente etj.</i> )	
14	<b>Agrotech and natural expo</b> ( <i>Prezantim produktesh dhe teknologjie, gastronomi etj.</i> )	
15	<b>Panairi ndërkombëtar i turizmit</b> ( <i>Promovimi i potencialit vendas</i> )	
16	<b>Food and drink expo</b> ( <i>Prezantim produktesh, kulinari etj.</i> )	
17	<b>Shfaqje teatrale</b> ( <i>tek teatri Metropol, ArTurbina, "Open Theatre" etj.</i> )	
18	<b>Shfaqje operistike</b> ( <i>tek TKOB etj.</i> )	
19	<b>Klub libri në Shtëpinë Studio Kadare</b> ( <i>Takime të hapura për publikun me shkrimtarë</i> )	
20	<b>Panairi i Librit</b> ( <i>Promovim i leximit</i> )	
21	<b>Filma, shfaqje dhe aktivitete</b> ( <i>Kinema Agimi, Maks Velo në Laprakë</i> )	

## Seksioni II: Promovimi dhe pritshmëritë

4. Në opinionin tuaj, mendoni se BT-ja po i bën një promovim të mirë aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme?

Po     Jo     Pjesërisht     Nuk e di

5. Çfarë përfitimesh mendoni se i sjellin qytetit dhe qytetarëve aktivitetet dhe eventet që organizohen në kryeqytet? (Mund të zgjidhni më shumë se 1)

- Rritja e angazhimit të komunitetit dhe ndërveprimit social
- Promovimi i kulturës dhe trashëgimisë lokale
- Nxitja e ekonomisë lokale nëpërmjet turizmit
- Përmirësimi i imazhit dhe reputacionit të qytetit
- Rritja e cilësisë së jetës për banorët

Tjetër: \_\_\_\_\_

6. Në bazë të pjesëmarrjes tuaj dhe informacionit që keni mbi aktivitetet dhe eventet, si e vlerësoni cilësinë e organizimit dhe mbarëvajtjes së tyre?

- Shumë e lartë
- E lartë
- Mesatare
- E ulët
- Shumë e ulët



**7. A mendoni se pritshmëritë tuaja për këto aktivitete janë rritur krahasuar me vitin e kaluar?**

- Po, shumë
- Po
- As më shumë as më pak
- Jo
- Jo, Aspak

**Seksioni III: Interesi dhe përfshirja e qytetarëve**

---

**8. Në perceptimin tuaj, mendoni se është rritur interesi i qytetarëve për të qenë pjesëmarrës në këto organizime?**

- Po     Jo     Ndoshta     Nuk e di

**9. Sa të rëndësishme janë për ju këto elementë kur vendosni të merrni pjesë në një aktivitet?**

*(Vlerësoni nga 1 - aspak e rëndësishme deri në 5 - shumë e rëndësishme)*

a) Tematika e aktivitetit	1	2	3	4	5
b) Artisti apo performuesi i ftuar	1	2	3	4	5
c) Vendndodhja e aktivitetit	1	2	3	4	5
d) Çmimi i biletave	1	2	3	4	5
e) Koha dhe data e zhvillimit	1	2	3	4	5
f) Mundësia për të mësuar diçka të re	1	2	3	4	5
g) Mundësia për të takuar njerëz të rinj	1	2	3	4	5

**10. Si mendoni se mund të përfshihet më tepër komuniteti në aktivitetet dhe eventet që organizon Bashkia e Tiranës? (Mund të zgjidhni më shumë se 1)**

- Rritja e promovimit përmes kanaleve të mediave sociale
- Bashkëpunime me grupe dhe organizata të komunitetit lokal
- Më shumë hapësira të dedikuara
- Lehtësira për grupet vulnerabël
- Përmirësimi i aksesit dhe opsioneve të transportit në vendet e eventeve
- Produkte me çmime të reduktuara për nxënës dhe studentë
- Kushte më të përshtatshme për orët e nxehta/ftohta (freskuese, tenda etj.)
- Stimuj dhe shpërblime për pjesëmarrësit
- Internet falas

Tjetër: \_\_\_\_\_

**Shënim:** Ky sondazh organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet për aktivitetet dhe eventet që organizon Bashkia e Tiranës, frekuentimin nga qytetarët, përshtypjet dhe pritshmëritë për organizimin dhe mbarëvajtjen. Ju sigurojmë se të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin Nr. 38/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"; Ligjin Nr. 78/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit"; Ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar".

**Aneks II – Pikat ku është zhvilluar anketimi**

<b>Nr.</b>	<b>Pikat e përcaktuara për anketim</b>	<b>Pyetësorë</b>
1	Përreth Sheshit Skënderbej - Blv.Zogu I - Rr. Kavajës	70
2	Pazari i Ri - Rr. Hoxha Tahsin - Rr. Dibrës	70
3	Kalaja e Tiranës - ish-7 Xhuxhat - Bryli	70
4	Pedonale - Rr. M. Shyrri	70
5	Përreth Sheshit Italia - Arena - Rr. Elbasanit	70
6	Parku i Liqenit Artificial	70
7	Parku Rinia - Kryqëzimi V. Shanto	70
8	Sheshi Bukuresht - Rr. Durrësit - Zogu i Zi	70
9	Piramida dhe zona përreth	70
10	Zona e ish-Blokut - Komuna e Parisit	70
<b>Total</b>		<b>700</b>